



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2021:158949

Datë: 11.12.2023

Numri i dokumentit: 05044257

C.nr.601/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Bajram Cacaj, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit S.G, nga Juniku, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.SH. avokat në Pejë, kundër të paditurës Komuna e Junikut, Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e diferencës në pagë mbi bazën e licencimit, vlera e kontestit 3.253,50 €, jashtë seance me datë 11.12.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M
- për shkak të mosbindjes –

I. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit S.G, nga Juniku dhe DETYROHET e paditura Komuna e Junikut, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit në emër të pagesës për diferencën në pagë për shkak të licencimit, për periudhën 19.07.2018 e deri me datën 06.02.2023, për 54 muaj dhe atë për kualifikim me diplomë universitare në vlerë të 27% nga paga bazë për secilin muaj veç e veç, t'i paguaj shumën në lartësi prej 60,25 €, e në shumë të përgjithshme prej 3.253,50 €, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 19.07.2021 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Junikut, Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit të ia paguaj shumën prej 248,00 €, në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi S.G, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, me datë 19.07.2021 ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Junikut, Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e

diferencës në pagë mbi bazën e kualifikimit, duke theksuar se paditësi është i punësuar në Gjimnazin “Kuvendi i Junikut” në Junik, respektivisht ka të lidhur kontratë pune në afat të pacaktuar me të paditurën, me ç’rast paditësi mban titullin e punës profesor i matematikës dhe pasi që paditësi është i diplomuar me diplomë të Fakultetit të Edukimit dhe ka gradën “Bachelor i programit Matematikë - Informatikë” dhe po ashtu i njëjti ka licensën e mësimdhënësit me numër 100017620 me datë lëshimi 13.12.2013 dhe datë të skadimi 13.12.2018, vlefshmëria e secilës është zgjatuar për 5 vite dhe bazuar në vendimin e Qeverisë nr. 01/33 i datës 29.08.2008 palës paditëse i takon kjo e drejtë dhe me padi ka kërkuar që e njëjta të kompensohet në emër të pagesës për diferencë në pagë për shkak të licencimit, me kamat ligjore, si dhe i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës. I autorizuari i paditësit, me parashtresën e datës 20.10.2023 ka precizuar kërkesëpadinë, duke kërkuar që për periudhën nga data 19.07.2018 e deri me datë 06.02.2023, për 54 muaj paditësit t’i kompensohet shuma prej 3.253,50 €, ka kërkuar kamatën ligjore, si dhe shpenzimet procedurale.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendim për përgjigje në padi me datë 01.11.2023, ku me këtë aktvendim është njoftuar e paditura për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do të i ketë nëse nuk e paraqet të njëjtën, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes. E paditura, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë, provat dhe parashtresën për precizim, me datë 08.11.2023 (që vërtetohet nga fletëkthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës), në këtë çështje juridiko-kontestimore, e njëjta nuk ka paraqitur përgjigje në padi.

Gjykata pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë nga neni 150 paragrafi 1 pika a), b) dhe c) të LPK, pasi që të paditurës i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi, si dhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Themelësia e kërkesëpadisë del nga shkresat e lëndës që i janë bashkangjitur padisë, nga të cilat gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe atë profesor i matematikës, konkretisht në Gjimnazin “Kuvendi i Junikut” në Junik, i njëjti ka diplomuar në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Prizren, me datë 22.11.2014 dhe ka marr titullin “Bachelor i Programit Matematikë - Informatikë”, po ashtu posedon licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës, vlefshmëria e së cilës është vazhduar edhe për 5 (pesë) vite konform Udhëzimit Administrativ të MASHT, numër 05/2017 neni 33 par. 1. Paga bazë e paditësit ka qenë 459 € dhe në emër të licencës për çdo muaj i është paguar shuma prej 63,68 €.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri me datë 06.02.2023 ku është shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik numër 08/L-196. Sipas këtij

vendimi, në pikën 1 është përcaktuar se *“Që nga data 01.09.2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*, ndërsa pika 4 nënpika 3 e tij, ka përcaktuar se *“Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%”*. Pasi që nga provat e lartcekura u vërtetua se paditësit është në marrëdhënie pune të e paditura, se i njëjti ka diplomë universitare me titull “Bachelor i Programit Matematikë - Informatikë” dhe ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës, rezulton se konform vendimit të lartcekur, paditësit i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, më konkretisht të pjesës së pa kompensuar lidhur me këtë të drejtë monetare për çdo muaj për periudhën kohore nga data 19.07.2018 deri me datë 06.02.2023 apo për 54 muaj, ashtu që për këtë periudhë paditësit i takon diferenca në shumën prej 60,25 € për çdo muaj, apo shuma e përgjithshme prej 3.253,50 €, për këtë kriter të kompensimit.

Andaj, gjykata vlerëson se nga provat e lartcekura del baza dhe lartësia e kërkesëpadisë, andaj në kuptim të nenit 150 të LPK, e në lidhje me dispozitat nga neni 245 paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), ku përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paraqitur nga ana e paditësit është e bazuar dhe në këtë rast e njëjta u aprovua në tërësi si e themeltë, duke obliguar të paditurën në pagimin e detyrimit sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8 %, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, gjykata e mori sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK, me ç‘rast paditësit iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 248,00 €. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20,00 €, të diferencës për taksë gjyqësore në vlerë prej 20,00 €, (të parapara sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), si dhe për përpilimin e padisë shuma prej 104,00 €, si dhe për përpilimin e precizimit të padisë shuma prej 104,00 € të parapara sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës nr. Tarifor 6 dhe 7).

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 150 par.1 të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË

Dega në Deçan

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.601/21, datë 11.12.2023

Gj y q t a r i

Bajram Cacaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimet të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.